# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-475269**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I ftoi në bisedime, Gjykata e Lartë dhe dy shoqatat e gjyqtarëve refuzojnë Ramën, ja deklarata |
| ADRESA | `https://lajmifundit.al/i-ftoi-ne-bisedime-gjykata-e-larte-dhe-dy-shoqatat-e-gjyqtareve-refuzojne-ramen-ja-deklarata-i1338951` |
| BURIMI | lajmifundit.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 07:39:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 09:39:45 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6f142d37a7933781f736314f3765ebed3bbe88d7a396947cce1a91fb3d714aeb` |
| TEKSTI | `316d14fb6b8f0fde151d53326e596fb6c4dfe11d6db0689c3c7e10960e6a9c24` |
| PAMJA | `b4ce34d2311fadaf07dfa97a770cea67d964a27741a0502d46677d718ad70dd7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8abce735cc6047c0e04aa96d5192e42d77a95863b97bba442da99f36ffcbb631` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8abce735cc6047c0e04aa96d5192e42d77a95863b97bba442da99f36ffcbb631`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

I ftoi në bisedime, Gjykata e Lartë dhe dy shoqatat e gjyqtarëve refuzojnë Ramën, ja deklarata Lexo lajmin e plote
Skandal financiar me shuma të majme në Turqi, nënkryetarja e AKP-së jep dorëheqjen Lexo lajmin e plote
Çfarë dihet deri më tani? Nën akuzë për abuzim ndaj të miturve, arrestohet 56-vjeçari shqiptar Lexo lajmin e plote
Goditen tre raste nga policia në Kukës e Tropojë, arrestime, ar'më dhe dro'gë Lexo lajmin e plote
Sulmoi gruan me kaçavidë dhe përplasi dy persona, tmerr në një karburant në Itali Lexo lajmin e plote

# I ftoi në bisedime, Gjykata e Lartë dhe dy shoqatat e gjyqtarëve refuzojnë Ramën, ja deklarata

LAJMIFUNDIT / 28 SEPTEMBER 2026, 09:39

Shperndaje

AKTUALITET



Ftesa e kryeministrit Edi Rama për një tryezë konsultimi mbi pagat e magjistratëve është refuzuar nga Gjykata e Lartë dhe dy shoqata të gjyqtarëve. Të treja argumentojnë se për sa kohë ligji i ri është ankimuar në Gjykatën Kushtetuese, diskutimi për formulën e pagave duhet të presë vendimmarrjen e saj.

Kreu i Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi, njoftoi se institucioni që drejton nuk do të përfaqësohet në tryezë.

Sipas tij, tashmë ka një zhvillim të ri nga momenti kur Rama bëri ftesën, pasi ligji i është nënshtruar kontrollit kushtetues dhe për këtë arsye fjalën duhet ta thotë fillimisht Gjykata Kushtetuese.

"Për një çështje kushtetuese tashmë të shtruar për gjykim, fjala i përket Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, dialogu për këtë objekt mund të jetë substancial dhe efektiv pasi ajo të jetë shprehur", tha Sadushi.

Të njëjtin qëndrim mban edhe Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë.

"Deri në një vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me padinë e paraqitur nga shoqatat e magjistratëve, është e pamundur për ne pjesëmarrja në tryezën e konsultimit të datës 28 shtator 2026", thuhet në përgjigje.

Edhe Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve ka vendosur të mos marrë pjesë. Ajo vlerëson se fillimisht Kushtetuesja duhet të qartësojë standardet mbi pagat dhe vetëm më pas mund të zhvillohet një diskutim me qeverinë për mekanizmin e ri.

MOTI NE TIRANE
Tirana, Albania

POLITIKË
Protesta në ditën e 120, qytetari: Vuajmë për bukën e gojës, Rama tallet

POLITIKË
"S'jam engjëll, ama...", Rama: Nuk ka bir nëne që gjen një qindarkë të tijën në xhepin tim!

TRENDING
Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencues dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë
Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë

**LEXONI GJITHASHTU**



**Skandal financiar me shuma të majme në Turqi, nënkryetarja e AKP-së jep dorëheqjen**



**Çfarë dihet deri më tani? Nën akuzë për abuzim ndaj të miturve, arrestohet 56-vjeçari shqiptar**




**Goditen tre raste nga policia në Kukës e Tropojë, arrestime, ar'më dhe dro'gë**

“Shoqata vlerëson se nuk do të ishte e përshtatshme pjesëmarrja e saj në një diskutim institucional mbi të njëjtën çështje përpara përfundimit të këtij procesi”, thotë Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve.

Shoqatat e ndryshme të magjistratëve iu kundërvunë hapur qasjes së shumicës, e cila nuk ndërmori asnjë veprim që të miratonte një formulë të re brenda 31 korrikut të këtij viti, siç udhëzonte Gjykata Kushtetuese. KLGJ dhe KLP ndërmorën vendime të posaçme duke miratuar ato vetë nivelin e pagave për muajin gusht, duke iu referuar vendimit të GJK.

Situata çoi në një përplasje mes ekzekutivit dhe institucioneve të Drejtësisë. Ministria e Financave nuk miratoi veprimet e Thesarit për kalimin e pagave sipas vendimeve të KLGJ dhe KLP-së. Magjistratët u përgjigjën duke kallëzur në SPAK, ministrin e Financave dhe duke vënë në lëvizje gjykatën administrative e cila urdhëroi anullimin e vendimit të ministrit, dhe kalimin e pagave për gjykatat e prokuroritë në të gjithë vendin.

Në parlament, shumica miratoi më 18 shtator, me 84 vota pro formulën e re të pagave të magjistratëve që përcakton se paga referuese e magjistratëve do të jetë sa 38% e pagës së Presidentit të Republikës nga 36% që ishte, me një rritje prej rreth 8500 lekësh.

Rritja me 8500 lekë e pagës referencë është 9-fish më e vogël se ajo që vetë magjistratët thonë se ka vendosur GJK. Tre ditë më pas, më 21 shtator, shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve dorëzuan në Kushtetuese kërkesën për pezullimin e formulës së miratuar nga parlamenti dhe shfuqizimin e saj.

POLITIKË

**“Korrupsioni nuk po shtohet, po goditet”, Rama: Hetimet e drejtësisë, si dëshmi e një kapitulli të ri**

POLITIKË

**Publikimi i mesazheve të Vlora Hysenit me Ergys Agasin, Rama për SPAK e GJKKO: Nxorën në pazar sekretet hetimore**

## ME TE LEXUARAT

“Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e...

Lexo lajmin e plote

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

Lexo lajmin e plote

Skandali “Xhaka” merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!...

Lexo lajmin e plote

## ME TE LEXUARAT

“Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e Gjovalin Lazrit

Lexo lajmin e plote

## NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

Kliko për më shumë informacion

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
Lexo lajmin e plote

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!
Lexo lajmin e plote

"Askush nuk është mbi ligjin"/ Rama shkarkon menjëherë Vlora Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH
Lexo lajmin e plote

Sekuestrohet hoteli "Central Park Premium" në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket
Lexo lajmin e plote

"Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot"/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap
Lexo lajmin e plote

LAJMI FUNDIT

KUSH JEMI KONTAKT REDAKSINË TE DHENAT PERSONALE COOKIES

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by Mediadesk

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do te merrni njoftime periodike me Lajmet e Fundit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.